

### Atraksionet turistike në komunën e Prishtinës

Nr.	Emërtimi	Përshkrimi i atraksionit	Kategoria	Adresa	Komuna
1	Parku Nacional rekreativ „Gërmia“	Është Park regional i shpallur zonë e mbrojtur. Ka një sipërfaqe prej 62km <sup>2</sup> Karakterizohet me bukuri dhe vlera natyrore. Zona e mbrojtur përfshinë dhe këndet për pushim dhe rekreacion: Pishina, fusha sportive, shtigje të hecjes, restorante dhe pika tjera të çlodhjes.	Atraksion natyror	Prishtinë	Prishtinë
2	Monumenti i Gjergj Kastrioti-Skenderbeut	Monumenti i Gjergj Kastrioti-Skenderbeu, ky monument gjendet në qendër të kryeqytetit, afër ndërtesës së Parlamentit dhe Qeverisë së Kosovës. Ky monument ka një rëndësi të veçantë dhe simbolizon heroin kombëtar për të gjithë shqiptarët në rajonin e Ballkanit.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
3	Katedralja “Nëna Terezë”	Katedralja Katolike Romake është një nga atraksionet më të vizituara në Prishtinë, e cila u ndërtuar në vitin 2007. Katedralja i është përkushtuar murgeshës së njohur shqiptare-indiane romake katolike dhe misionare, Shën Tereza e Kalkutës. Gjithashtu Kulla e katedrales është një aset i veçantë për vizitorët e cila është e hapur për vizitorët për tu ngjitur lartë në maje prej ku edhe ofrohet një pamje facsinuese e qytetit të Prishtinës.	Atraksion kulturor	Bulevardi Bill Klinton	Prishtinë
4	Monumenti “New Born”	New BORN-një monument me shtatë shkronja që ka domethënje të madhe si " Lindje e re". Është e vendosur në qendër të Prishtinës, i cili përfaqëson shtetin më të ri në botë që nga viti 2008. Pamja e tij ndryshon në mënyrë periodike çdo vit sipas ngjarjeve të mëdha që ndodhin në vend, veçanërisht në përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt. Pikturat e reja grafit janë të hapura për të gjithë për kontributin e tyre, duke përfshirë edhe turistët.	Atraksion kulturor	Luan Haradinaj	Prishtinë
5	Biblioteka Kombëtare	Biblioteka Kombëtare e Kosovës gjendet në mes të Fakulteteve të Universitetit të Prishtinës. Biblioteka u nërtua në vitin 1974 e cila tani është një monument i i veçantë i trashëgimisë kulturore edhe për shkak të silitit arkitektonik. Ky monument është si tërësi arkitekturore paraqet një kombinim të kubeve dhe kupolave dhe i takon tipit të arkitekturës të “regjionalizmit të ri”.	Atraksion kulturor	Kompleksi Universitar	Prishtinë
6	Xhamia e Mbretit – Xhamia e madhe	U ndërtua në vitet 1460-1461 nga Sulltan Mehmeti II al-Fatih-u Ajo gjendet të qendër së qytetit të vjetër, dhe është xhamia më e madhe e Prishtinës. Nga viti 1953 kjo xhami quhet: Xhamia e Sulltan Mehmet II al-Fatih-ut.	Atraksion kulturor	Qendër e qytetit të vjetër	Prishtinë
7	Xhamia e Çarshisë	E ndërtuar në shek. e XV nga Sulltan Bajaziti për të përkujtuar fitoren e osmanëve në vitin 1389. Në të kaluarën Xhamia e Çarshisë gjendej përballë çarshisë së mbuluar të Prishtinës. Simboli i saj kulmi i gurët i minares ka mbijetuar për më shumë se 600 vite. Këtë xhami e quajnë edhe “Tash Xhamia”, që në përkthim do të thotë “Xhamia e gurit”. Në afërsi të kësaj xhamie ndodhet edhe “Shatërvani”, nga mermeri i dekoruar, i cili sot është i vetmi i këtij lloji ndër dhjetra të tjerë që kishin qenë në të kaluarën historike.	Atraksion kulturor	Nazim Gafurri	Prishtinë

8	Ikonostasi në kishën e Shën Nikolës, dhe dy shtëpi të arqipeshkëvisë	Kisha e Shën Nikollës ka qenë kisha e vetme ortodokse në Prishtinë. U ndërtua në shekullin e XIX. Pjesa më e rëndësishme e kishës ka qenë ikonostasi i skalitur më 1840, dhe i futur nën mbrojtje me ligj.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
9	Sahat Kulla	U ndërtua në shekullin e XIX. Zijla origjinale u soll nga Moldavia dhe mbante mbishkrimin: ‘Kjo zile është punuar më 1764 për Jon Moldova Rumenin. Nodhet në zonën e vjetër të qytetit të Prishtinës. Është një ndër monumentet më të rëndësishme të arkitekturës utilitare në Prishtinë. Sahat Kulla ka formë gjashtëkëndëshe me një lartësi prej 26 metra, e muratuar në pjesën e poshtme me gurë, kurse në pjesën e sipërme me tulla të argjilës.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
10	Hamami i Prishtinës	Daton që nga shekulli i XV. Dikur ishte pjesë themelore e kompleksit të Xhamisë së Mbretit (Fatih).Ky hamam ka pasur 15 kupola me vrma të vogla në mënyrë që të hynte drita brenda objektit.Tregimi për këtë ndërtesë është se ajo ishte ndërtuar si pjesë e Xhamisë së Madhe dhe që Sulltani i detyronte punëtorët që punonin në xhami të përdornin hamamin çdo ditë. Ndërtesa që fillimisht kishte 18 kupola, ishte e ndarë barabartë në mes të banjove të grave dhe burrave. Hamami që është një ndërtesë e mbrojtur me ligj, u përdor si hamam deri në vitet 1960. Edhe pse ndërtesa ka humbur shumë nga karakteristika origjinale të saj, ajo njihet si pjesë e rëndësishme e kujtesës kolektive të Prishtinës.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
11	Muzeu Kombëtar i Kosovës	Muzeu i Kosovës është ndërtuar nga austriakët për ushtrinë turke në vitin 1898.Muzeu ka pasur një koleksion të pasur të objekteve prehistorike të zbuluara në Kosovë. Pjesa më e madhe e artefakteve tregon për jetën në kohën e ilirëve dhe romakëve . Më 1998, më shumë se 1.247 artefakte u dërguan në Beograd për një ekspozitë. Muzeu ende është duke pritur kthimin e tyre	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
12	Muzeu Etnologjik - Kompleksi i banimit Emin Gjiku	Monument i kulturës nga shekulli i 18-të. Kjo ndërtesë dikur ka qenë pronë e familjës së njohur Gjinoalli. Prej vitit 1957 ky grup ndërtesash, duke përfshirë këtu shtëpinë e shërbëtorëve, shtëpinë e mysafirëve dhe shtëpinë e familjës i takon Muzeut të Kosovës. Deri në vitin 1990 Kompleksi Emin Gjiku shërbeu si një muze i natyrës dhe pas përfundimit të punëve konservuese në vitin 2003, u shndërrua në një muze etnologjik që strehonte një koleksion të gjerë të veshjeve tradicionale, si dhe vegla, elemente të dorës dhe mjete të tjera të përdorura në jeta e përditshme.	Atraksion kulturor	Rr. Henrik Baric	Prishtinë
13	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës	I përkiste familjes Koçadishi përfaqëson shtëpinë e një tregtari tipik Osman gjatë shekullit 19-të,e cila kishte një verande, mure të larta rreth perimetrit dhe zonat e ndara në mënyrë rigorozë në kuadër të kompleksit për biznesin dhe çështjet e familjes .	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
14	Biblioteka “Hivzi Sylejmani”	U ndërtua në vitin 1930. Ajo u bë e famshme nga Miladin Popoviqi – ish-udhëheqës i Komitetit regional të Partisë komuniste të Kosovës – që qëndroi këtu në vitin 1944. Nga viti 1948 kjo ndërtesë u shndërrua në Bibliotekën e qytetit të Prishtinës.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
15	Ndërtesa e Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës	Është një nga shtëpitë e vetme të mbetura të stilit të shtëpive qytetare të shekullit XIX. Akademia e Arteve dhe Shkencave është e vendosur në këtë ndërtesë prej themelimit të saj, në vitin 1975.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë

16	Shtatorja "Bill Klintonit"	Në vitin 2009 është punuar shtatorja e ish-presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Klinton, nga skulptori Izeir Mustafa. Shtatorja u punua për ta nderuar presidentin për ndihmën dhe rolin e tij gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë. Gjatësia e skulpturës është rreth 3 metra dhe në dorën e majtë presidenti e mban mirënjohjen 'Honoris Causa' që i është dhënë nga Universiteti i Prishtinës. Shtatorja është e vendosur në sheshin e emëruar sipas presidentit Bill Klinton.	Atraksion kulturor	Bulevardi Bill Klinton	Prishtinë
17	Ndërtesa e Radio Prishtinës	Ndërtesa e Radio Kosovës është një nga shembujt më përfaqësues të arkitekturës moderniste të shekullit XX në Prishtinë. Ndërtesa u projektua në vitin 1982 dhe u ndërtua disa vite më vonë. Dizajnimi i saj u bë nga studioja shtetërore "Slovenia Projekt" nga Lubjana, që për kryesues të ekipit punues kishte arkitektin Franc Rihter.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
18	Galeria Kombëtare e Kosovës	Ndërtesa e Galerisë Kombëtare u ndërtua rreth vitit 1935 si bazë për ushtrinë jugosllave. Në vitet 1955-1981 funksionoi si bibliotekë. Midis viteve 1982-1983, ajo u adaptua si një sallë ekspozite nga arkitekti Agush Beqiri për Muzeun Revolucionar të Kosovës. Galeria Kombëtare si një institucion kulturor për prezantimin e arteve pamore dhe për mbledhjen dhe ruajtjen e veprave të artit, u themelua në vitin 1979. Në 30 vitet e fundit të veprimtarisë së tij, ky institucion ka organizuar afro 500 ekspozita dhe ka bërë përvetësimin e afro 1000 veprave të vlefshme të artit, me të cilat është krijuar një fond i pasur i Galerisë. Galeria Kombëtare është institucioni më i madh dhe më i vjetër i artit pamor në Kosovë.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
19	Pallati i Rinisë dhe Sporteve "Boro e Ramiz"	I ndërtuar në vitin 1977 me një hapësirë rreth 10,000 metra katror, Pallati i Rinisë dhe Sporteve është një ndër objektet me investimin më të madh financiar dhe fizik të Kosovës në vitet '70-a. Kjo ndërtesë me vite të tëra ka qenë qendra e zhvillimit të jetës shoqërore në Prishtinë, ku janë ndërtuar të gjitha aktivitetet e përditshme të qytetarëve. Me arkitekturën e saj moderne, organizimin e hapësirave me funksione të ndryshme, është një prej ndërtesave më karakteristike në Prishtinë, e prezantuar kudo në kartolina e në foto të guidave turistike. Pallati i Rinisë dhe i Sporteve prezanton në mënyrë dinjitoze arkitekturën e viteve '70, jo vetëm në Kosovë, por edhe në tërë rajonin. Që nga viti 2016, ndërtesa është pjesë e listës së Monumenteve për Mbrojtje të Përkohshme.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
20	Memoriali "Heroinat"	Memoriali i Heroinatit (HEROINAT) është një skulpturë tipografike dhe atraksion turistik në Prishtinë, Memoriali është vendosur në qendër të Prishtinës, në një nga zonat më qendrore dhe më të frekuentuara të Prishtinës, përballë monumentit të Newborn. Ajo u përvetësua më 12 qershor 2015, e festuar si Dita e Çlirimit të Kosovës. Monumenti u fokusua në krijimin e një fytyre përfaqësuese të gruas kosovare. Projekti është realizuar kryesisht me hulumtime fotografike, duke kombinuar portrete të ndryshme, me tiparet e tyre të zakonshme. HEROINAT përshkruan një grua shqiptare duke përdorur 20,000 gozhda. Çdo gozhdë përfaqëson një grua të përdhunuar gjatë Luftës së Kosovës nga viti 1998-1999. Gozhdat janë në lartësi të ndryshme, duke krijuar një portret në sipërfaqe. Skulptura ka një perspektivë të dyfishtë, makro dhe mikro. Shikuar nga një perspektivë e afërt, medaljet individuale të portreteve janë të dukshme. Më tutje shfaqet portreti.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë

21	Monumenti i “Zahir Pajazitit”	Zahir Pajaziti ishte njeri ndër komandantet e parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lindi në Orllan të Podujeves. Nga dyert e kësaj familje kanë dalë ushtarake që në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore. Në vitin 1991 pasi që në Kosovë fillojnë që punët e ilegalës të kordinoheshin me legalen Zahiri shkon në Shqipëri për qëllime ushtarake. Me të kthyer në Kosovë në vitin 1992, grupi i tij zbulohet dhe Zahirit i duhet të kalojë në ilegalitet për disa muaj. Deri në 1992 ai kontribuoi në furnizimin me armatim të shtabeve të krijuara në rrethinën e Orllanit. Gjatë vitit 1994, Zahiri filloi të angazhohet edhe në pjesë tjera të Kosovës për krijimin e UÇK-së. Kështu, ai është një nga themeluesit e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe anëtar i tij nga fillimi, nga ku fillon të bëhet koordinimi i aktiviteteve politike dhe ushtarake në të cilat Zahiri luante një rol të madh si në zgjerimin e fushës së ndikimit, po ashtu edhe në furnizimin me armatim. Më 31 janar Zahir Pajaziti duke udhëtuar nga Prishtina në Vushtri së bashku me bashkëluftëtarët Edmond Hoxha dhe nipin e tij Hakif Zejnullahu, forcat serbe kishin vënë pritë në fshatin Pestovë, ku të tre bien heroikisht në luftë me ta.	Atraksion kulturor	Sheshi Zahri Pajaziti	Prishtinë
22	Monumenti i “Nënës Terezë”	Shtatorja e Nënës Terezë simbolizon figurën e saj dhe madhësinë për veprat që la pas. Shtatorja gjendet në qendër të qytetit të Prishtinës, në sheshin që mban të njëjtin emër. Anjezë Gonxhe Bojaxhiu e njohur si Nënë Tereza lindi në Shkup të Maqedonisë më 26 gusht të vitit 1910 nga prindër shqiptar dhe vdiq më 5 shtator 1997 në Kalkuta, (Indi). Ajo ishte humaniste e njohur shqiptare, fituese e çmimit Nobel për Paqen, kurse më 19 tetor të vitit 2003 u shpall e bekuar nga Vatikani. Nënë Tereza u bë një nga urat ndër lidhëse të njohjes së shqiptarëve në botë.	Atraksion kulturor	Sheshi Nënë Tereza	Prishtinë
23	Teatri Kombëtar i Kosovës	Teatri Kombëtar i Kosovës u themelua në vitin 1946 në Prizren dhe në fillim kishte emrin Teatri Popullor Rajonal e pastaj Teatri Popullor Krahinor. Ky është institucioni i parë teatror profesionist në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Disa muaj pas themelimit, Teatri Popullor Krahinor u transferua në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. Deri në vitin 1989 ky teatër i ka realizuar mbi 400 premiera me rreth 10.000 repriza, të cilat janë përcjellë me nga mbi 3.300.000 spektatorë. Në vitin 1999, teatri pagëzohet me emrin Teatri Kombëtar i Kosovës dhe vazhdon aktivitetet e saja me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.	Atraksion kulturor	Sheshi “Skenderbe”	Prishtinë
24	Ndërtesa e “Unionit”	U ndërtua në vitin 1927 nën mbikëqyrjen e arkitektit austriak Andija Kremer. Stili i ndërtesës ishte ndikuar nga arkitektura evropiane e kohës, duke përmbajtur elemente të neo-renesancës dhe të neo-barokut. Ndërtesa e cila është e pozicionuar afër pazarit të vjetër të Prishtinës frekuentohej zakonisht nga tregtarët vizitorë.	Atraksion kulturor	Sheshi i Skenderbeut	Prishtinë
25	Monumenti i Ibrahim Rugovës	Ibrahim Rugova ishte Presidenti i parë i Republikës së Kosovës, duke shërbyer në vitet 1992–2000 dhe përsëri në vitet 2002–2006. Ishte intelektual, akademik dhe kritik letrar i njohur shqiptar u njoh si lider i lëvizjes më të madhe paqësore në Evropë, i lëvizjes së gjerë për emancipim, çlirim kombëtar e pavarësi të Kosovës. Për shkak të rolit të tij në historinë e Kosovës, Rugova është quajtur "Ati i Kombit" dhe "Gandi i Ballkanit", ndërsa pas vdekjes është shpallur Hero i Kosovës.	Atraksion kulturor	Sheshi Ibrahim Rugova	Prishtinë
26	Memoriali i të pa gjeturve	Ky memorial i dedikohet personave të pagjetur që janë zhdukur gjatë luftës në Kosovë të vitit 1998-1999.	Atraksion kulturor	Sheshi Ibrahim Rugova	Prishtinë

27	Përmendorja “Bashkim Vllazërim”	U dizajnuar nga skulptori serb Miodrag Zhivkoviç në vitin 1957 dhe u ndërtua në vitin 1959. Përmendorja Vëllazërim-Bashkim u ndërtua gjatë një kohe kur po ndodhnin ndryshime të mëdha shoqërore dhe arkitekturale në kryeqytetin e Kosovës. Autoritetet jugosllave sollën një frymë të re të modernizmit dhe brutalizmit e cila u manifestua nëpërmjet arkitekturës. Sipas autorit, përmendorja simbolizon bashkimin e etnive të ndryshme që jetonin atëkohë në Prishtinë.	Atraksion kulturor	Sheshi Adem Jashari	Prishtinë
28	Muzeu i Pavarësisë	Kjo ndërtesë ka qenë fillimisht Selia e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Në shkurt të vitit 2018 është shndërruar në Muzeun "Shtëpia e Pavarësisë së Kosovës dr. Ibrahim Rugova". Ndërtesa njëherësh shërbente si zyrë e dr. Ibrahim Rugovës. Në vitin 2004 dr. Ibrahim Rugova kishte propozuar që kjo shtëpi të shndërrohet në muze që do ta tregonte dhe simbolizonte rrugëtimin e Kosovës në çlirimin dhe pavarësimin e saj. Muzeu i Pavarësisë menaxhohet nga Muzeu i Kosovës.	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë
29	Parku i Arinjve	Është park kombëtar në Kosovë që gjendet në afërsi të qytetit të Prishtinës. Për shumë vite nuk kishte ligj për mbajtjen e ariut të kaftë në Kosovë. Të gjithë arinjtë e mbajtur privatisht kishin jetuar në kafaze të vogla nëpër restorante. Ata kishin lindur kryesisht në pyjet e Kosovës ose të Shqipërisë dhe janë rrëmbyer prej nënave të tyre nga tregtarët e kafshëve. Si arinj të restoranteve ata duhej të tërhiqnin klientë, dhe kështu pronarët e tyre përfitonin. Në nëntor të vitit 2010 u bë e paligjshme të mbahen arinjtë e kaftë privatisht, dhe kështu u shfaq nevoja për një park kombëtar, një strehë për arinjtë e shpëtuar nga robëria. Parku i Arinjve u themelua në vitin 2013 nga Four Paës Austria në bashkëpunim me KFOR-in, Komunën e Prishtinës, Ministrinë e Mjedisit të Kosovës, dhe firmën ligjore Franke & Partner	Atraksion natyror	Mramor	Prishtinë
30	Shtëpia e Herticëve	Është ndërtuar në vitin 1989 dhe që nga viti 1991 ka qenë e gatshme për banim. Pronar i kësaj shtëpie është Mehmet (Hertica) Aliu. Ndërtesa që aktualisht mban epitetin e kujtesës së represionit serb të viteve 90-të, para se të digjej nga forcat policore të Serbisë, ka shërbyer për gati dhjetë vite si shtëpi shkollë, ku ishin sistemuar mbi një mijë nxënës të gjimnazit “Sami Frashëri”. Familja e kësaj shtëpie ka jetuar në shtëpinë e vjetër e cila më vonë është rrënuar. Shtëpia e Mehmet Herticës në lagjen “Kodra e Trimave” ka mbetur mbase i vetmi objekt i cili pasqyron kujtimet e luftës së fundit në kryeqytetin e Kosovës	Atraksion kulturor	Prishtinë	Prishtinë